



KONKURSI PËR PËRZGJEDHJEN E LOGOS SË AGROTURIZMIT (Rregullorja)

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe GIZ shpall konkursin për përzgjedhjen e logos së Agroturizmit.

Agroturizmi dhe rritja e strukturave të agroturizmit, si një formë e diversifikimit ekonomik në zonat rurale është një ndër projektet strategjike të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Agroturizmi është një veprimtari me potencial të lartë zhvillimi, në funksion të rritjes ekonomike dhe përmirësimit të kushteve sociale në zonat rurale të Shqipërisë.

Konkursi nxit idetë inovative mbi ideimin e një logoje unike për agroturizmin shqiptar.

Konkursi për përzgjedhjen e logos së Agroturizmit fton të gjithë të interesuarit, të dorëzojnë propozimet e tyre nga **data 9 Tetor deri në datën 31 Tetor 2018**.

Ky konkurs do të zhvillohet në **dy faza**:

- Faza e parë do të zhvillohet nga **data 9 Tetor deri në datën 31 Tetor** për të përzgjedhur 5-7 aplikantët e parë, të cilët do të përmbushin idenë më të përafërt, përmes votimit individual me pikëzim nga juria.
- Faza e dytë do të zhvillohet pas përzgjedhjes së 5-7 aplikantëve, të cilët do të prezantojnë punimet e tyre në eventin përmbyllës, ku do të shpallet fituesi final.

<u>VLERËSIMI</u>			
Nr.	Cfarë vlerësohet	Shpjegim	Pikëzimi
1	Idea e përgjithshme	Në tërësi vlerësim për idenë	Nga 1 deri në 20
2	Realizimi Grafik	Zbërthimi në detaj i idesë	Nga 1 deri në 20
3	Ndërkombëtarizimi	Brandi / marka të mund të jetë potencialisht i përdorshëm edhe jashtë Shqipërisë	Nga 1 deri në 20

Në përfundim të dy fazave të konkursit, fituesi do të vlerësohet me çmimin prej **2000 Euro mundësuar nga GIZ**.



Të gjitha propozimet konkurruese do të vlerësohen nga një juri profesionistësh.

Kush mund të aplikojë dhe si?

Në konkursin për përzgjedhjen e logos së agroturizmit mund të marrin pjesë:

- Të gjithë të interesuarit: studentë, individë, studio, kompani të fushës, etj.

Aplikantët e interesuar për pjesëmarrje në konkurs mund të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare www.bujqesia.gov.al.

Të gjitha projekt idetë përkatëse mund të ngarkohen në format PDF në formën e aplikimit në faqen zyrtare www.bujqesia.gov.al.

Aplikantët të përzgjedhur nga juria do të njoftohen brenda datës **6 Nëntor 2018** dhe do të ftohen për të prezantuar idetë e propozuara në eventin përmyllës në datën **12 Nëntor 2018**.